VENDIM
Nr. 698, datë 22.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.744, DATË 5.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTAT E PRANIMITDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVEME KOHË TË PLOTË, "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTERI SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", PËR VITIN AKADEMIK 2013 - 2014"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.1, bashkëlidhur vendimit nr.744, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Hiqet kolona "Tarifa totale për 90 kredite (në lekë)";

b) Programi i studimit me numër ID 41 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në "Gjuhë - Letërsi", me profil minor në "Arte"";

c) Programi i studimit me numër ID 42 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në "Gjuhë - Letërsi", me profil minor në "Sporte"";

ç) Programi i studimit me numër ID 43 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë në "Gjuhë angleze", me profil minor në "Arte"";

d) Programi i studimit me numër ID 46 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm në "Shkenca sociale"";

dh) Programi i studimit me numër ID 47 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në "Matematikë-Fizikë", me profil minor në "Informatikë"". Programi i studimit me numër ID 47 ndryshohet në: "Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në "Matematikë - Fizikë", me profil minor në "Informatikë"".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama